



GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVES - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Saranda Bogaj Sheremeti, anëtare të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Triangle General Contractors”-INC me seli në Pejë, me numër unik identifikues 810218794, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.K., kundër të paditurit Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me seli në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.51/23 i datës 13.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I.** **Refuzohet** si e pabazuar ankesa e të paditurës Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me seli në Prishtinë, e datës 31.10.2023, sa i përket pikës dhe III. të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.51/23 i datës 13.10.2023 në pikën Idhe III. të dispozitivit, **Vërtetohet**.
- II.** Ndërsa miratohet si e bazuar ankesa sa i përket pikës II te dispozitivit të aktgjykimit, sa i përket shtyrjes së ekzekutimit të vendimit dhe çështja gjykohet si në vijim: **Refuzohet** kërkesa e paditësit për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të datës 30.09.2022 të protokoluar me nr. KSHA.nr.3691-4/22 datë 11.10.2022 sipas aktvendimit KA.nr.51/23 të datës 27.02.2023.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, në pikën I. të dispozitivit është aprovuar në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Triangle General Contractors”-INC dega në Kosovë, Anulohet Vendimi i datës 30.09.2022 i protokoluar me numër KSHA.nr.3691-4/22 datë 11.10.2022 i nxjerrë nga i padituri Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe çështja i kthehet të paditurit në rishqyrtim dhe rivendosje. Nën pikën II. Shtyrja e ekzekutimit të vendimit të datës 30.09.2022 të protokoluar me numër KSHA.nr.3691-4/22 datë 11.10.2022, sipas aktvendimit të kësaj gjykate KA.nr.51/23 i datës 27.02.2023, mbetet në fuqi deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi. Nën pikën III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi i padituri, ka ushtruar ankesë me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore,

konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të paditësit cili nuk e ka bërë të besueshme padinë dhe kërkesën, të vendos se paditësi duhet ti respektoj dispozitat ligjore për të ushtruar aktivitetin e saj andaj nga e gjithë kjo vlerëson se ankesa është e bazuar.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit ka paraqitur përgjigje në ankesë me të cilën ka konsideruar se me ankesë në mënyrë të pa kuptim theksohen gjërat që nuk kanë të bëjnë fare me lëndën kontestimore. Për më tepër i padituri me asnjë provë nuk arrijnë ti kontestojë provat dhe faktet zyrtare të cilat e paditura ia ka vënë në dispozicion gjykatës me të cilat me saktësi të lartë konstatohet se ankesa në procedurë tek i padituri ka qenë e afatshme dhe se i padituri ka nxjerrë vendim të gabueshëm. Andaj në këto rrethana konsiderojmë se gjykata e shkallës së parë duhet ta refuzojë këtë ankesë si të pa bazuar dhe ta lë në fuqi aktvendimin KA.nr.51/23 të 13.10.2023.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë shqyrtoi shkresat e lëndës aktgjykimin e ankimuar pretendimet në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49 të LKA, dhe neni 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, (LPK),i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA, gjeti se:

- Ankesa është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e të paditurit, numër KSHA- 3691-4/22 datë 30.09.2022, është Hedhur Poshtë ankesa me numër protokoli 3691-2/22 datë 23.08.2022 nga “Triangle General Contractors-INC”, Branch Kosova HC “Radac”- Pejë ushtruar kundër vendimit 22/INS-V-3-ID-10 datë 23.05.2022 të Inspektoratit në MMPHI-së, pas afatit ligjor.

Kundër Vendimit të paditurit, paditësi, inicicion konflikt administrativ, me padi i drejtohet gjykatës. Dhoma e Shkallës së Parë, në këtë çështje juridike administrative, me datë 10.10.2023, mban seancë të shqyrtimit kryesor në prani të autorizuarve të palëve ndërgjygjëse dhe pas administrimit të provave, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e aprovon kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, dhe shtyhet ekzekutimi i vendimit i datës 30.09.2022 të protokoluar me numër KSHA.nr.3691-4/22 datë 11.10.2022, sipas aktvendimit të kësaj gjykate KA.nr.51/23 i datës 27.02.2023, mbetet në fuqi deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimin, sipas konkludimeve në arsyetim se; Gjykata nga provat e administruara në këtë çështje të konfliktit administrativ ka konstatuar se paditësi me datë 05.08.2022 ka pranuar aktvendimin nr. rendor 10/2022 dhe nr.prot 22-INS-V-3-ID-10 të datës 23.05.2022, ndërsa ka parashtruar ankesë me datë 19.08.2023, përkatësisht ankesën e ka dorëzuar përmes postës në ditën 14 pas pranimit të vendimit të shkallës së parë. Gjykata ka konstatuar se i padituri në këshillën juridike të aktvendimit nr. rendor 10/2022 dhe nr.prot 22-INS-V-3-ID-10 të datës 23.05.2022 është përcaktuar afati për ankesë në kundërshtim me nenin 40 par.1 dhe 4 të Ligjit nr.0.4/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit, pasi që në vend të afatit 15 ditor të përcaktuar në këshillën juridike është dashur të përcaktohet afati 8 ditor për ankesë, por gjykata ka vlerësuar se një gabim i tillë i të paditurit nuk mund të ketë pasoja për paditësin pasi që i njëjti ka vepruar në përputhje me këshillën juridike të dhënë në vendimin e shkallës së parë duke ushtruar ankesë brenda afatit të përcaktuar në këshillën juridike, andaj gjykata ka vlerësuar se ankesa e paditësit duhet trajtuar si ankesë e ushtruar brenda afatit ligjor dhe se e njëjta të shqyrtohet me meritë nga i padituri. Gjykata ka vlerësuar si të bazuara pretendimet e paditësit për anulimin e vendimit kontestues pasi që gjeti se i

padituri në procedurë administrative ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi kur ka hedhur ankesën e paditësit si të pa afat. Gjykata e ka obliguar organin e paditur, në kuptim të nenit 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative, që në afat prej 30 ditësh, në ri procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në aktgjykim dhe ti mënjanoj të metat lidhur me vendimin kontestues ashtu që të trajtoj ankesën e paditësit si të afatshme dhe të shqyrtoj pretendimet e paraqitura në ankesë lidhur me aktvendimin nr.rend.10/2022 dhe nr. prot. 22-INS-V-3-ID-10 të datës 23.05.2022.

Qëndrimin juridik të Dhomës së Shkallës së Parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj sa i përket pikës I. të dispozitivit të cilën e pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë iu ka referuar nenit 40 të Ligjit nr.04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit i cili përcakton se: “Kundër aktvendimit të inspektoratit të Ministrisë nga neni 39 i këtij ligji, mund të ushtrohet ankesë në afate prej tetë (8) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit. 2. Ankesa kundër aktvendimit të inspektorit në nivel lokal, shqyrtohet nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në Komunë, brenda 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit. 3. Kundër aktvendimit të Komisionit për shqyrtimin ankesave në Komunë, mund të ushtrohet ankesë në Ministri, në afate prej 8 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit. 4. Ankesa kundër aktvendimit të inspektorit të Ministrisë, në afate prej 8 ditësh shqyrtohet nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave në Ministri. 5. Kundër aktvendimit të Ministrisë, mund të iniciohet konflikt administrativ me padi në gjykatën kompetente brenda 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi” Andaj kolegji vlerëson se i padituri ka vepruar në kundërshtim me nenin 40 par. 1 dhe 4 të Ligjit 04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit, pasi që nuk ka përcaktuar saktë afatin ditor në këshillën juridike kështu që në vend të afatit 15 ditor ka përcaktuar afatin 8 ditor për ankesë, ku në këtë rast kolegji njëjtë si Dhoma e Shkallës së Parë ka konstatuar se paditësit ka vepruar në përputhje me këshillën juridike të dhënë në vendimin e shkallës së parë dhe se ankesa është e afatshme, prandaj si e tillë duhet të trajtohet si e ushtruar brenda afatit ligjor dhe se e njëjta duhet të shqyrtohet me meritë nga i padituri

Kolegji, po ashtu vlerëson se të gjeturat e Dhomës së Shkallës së Parë janë të drejta dhe të bazuara sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike, kur vendimin e saj e mbështet në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative që në ri procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në aktgjykim dhe ti mënjanoj të metat lidhur me vendimin kontestues ashtu që ta trajtoj ankesën e paditësit si të afatshme dhe të shqyrtoj pretendimet e paraqitura në ankesë lidhur me aktvendimin me nr.10/2022 dhe nr.prot. 22-INS-V-3-ID-10 të datës 23.05.2022.

Pretendimet ankimore të paditurës se ka aplikuar drejtë dispozitat ligjore duke i vlerësuar të gjitha rrethanat dhe provat të cilat kanë ndikuar në nxjerrjen e vendimit ligjor dhe të drejtë dhe mbi këto arsye dhe shkaqe ka hedhur ankesën e palës në procedurë, kolegji i refuzon si të pa bazuara, jo të qëndrueshme dhe pa ndikim për vendosjen ndryshe të çështjes, sepse është dashur ta vendos me vendim përfundimtar përmbajtjesor dhe të qartë sipas formës dhe përmbajtjes, ashtu si parashihet me dispozitat e cekura të LPA, duke bërë përmbledhjen

e konstatimeve faktike edhe sipas dispozitave të ligjit për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit, e jo vetëm të hedhë poshtë ankesën e palës paditëse, pa dhënë arsye të plota dhe të qarta në vendimin e saj me të cilin mohohen, shuhen, kufizohen apo preken në ndonjë mënyrë të drejtat dhe interesat ligjore ose vendosen detyrime apo ndëshkime për palët ashtu si parashihet në nenin 85.1 pika a),b),c), i LPA-së, si në rastin konkret kur i hedhet ankesa e paditësit. E paditura në rastin konkret nuk ka paraqitur asnjë provë konkrete me të cilën do të mund të konstatonte se ankesa e paraqitur në procedurë administrative tek i padituri është e pas afatshme.

Duke marrë parasysh se Dhoma e Shkallës së Parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit si në pikën I dhe III. të dispozitivit të aktgjykimit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Dhoma e Shkallës së Dytë, konform nenit 182 pika (n) të LPK-së, vendosi që ta prish pikën II të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, sa i përket shtyrjes së ekzekutimit të vendimit, nga shkak se nuk ka prova të mjaftueshme të cilat do të ndikonin në një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga Dhoma e Shkallës së Dytë, dhe mbi këtë bazë refuzohet si e pabazuar.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.1555/23, me datë 25.04.2024

Kryetar i kolegjit,
Faton Bajrami